



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk.II.nr. 1229/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbareme të kreditorit Premium Bau Sh.p.k, me nr. unik identifikues 811277442, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.Sh. nga Prishtina, kundër debitorit DT MINING Sh.p.k, me nr. unik identifikues 811287350, me seli në Prishtinë, Bregu i Diellit, rr. “Hajrullah Abdullahu” nr.30 duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1680/22 të datës 30.06.2023, me datë **01.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e Debitorit DT MINING Sh.p.k, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1680/22 të datës 30.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar 1680/22 të datës 30.06.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit DT MINING Sh.p.k., me numër unik identifikues 811287350, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbareme P.nr. 08/22, i lejuar me datë 28.01.2022, nga Përmbaremi Privat Irfan Kerçagu, për pjesën e detyrimit në shumën prej EUR 20.00. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit DT MINING Sh.p.k., me numër unik identifikues 811287350, për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 30,533.10, së bashku me kamatëvonesën prej 8% në vit, dhe në këtë pjesë ka lënë në fuqi Urdhrin përmbareme P.nr. 08/22, i lejuar me datë 28.01.2022, nga Përmbaremi Privat Irfan Kerçagu.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1680/22 të datës 30.06.2023

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se debitori është qartazi i pa bazuar dhe i pambështetur me prova dhe me fakte dhe ankesa e parashtruara nga ana e

tij ka për qellim vetëm prolongimin e procedurës përbarimore . Andaj ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë, që të refuzoj në tërësi ankesën e debitorit dhe të vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1680/22 të datës 30.06.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Premium Bau Sh.p.kme dt. 28.01.2022,ka paraqitur propozim për përbarim mbi bazën e dokumenteve të besueshme - Faturës me nr. 2020-SHV01-001-14 të datës 01.09.2020 ka lejuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 08/22, të datës 28.01.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumë prej 30,553.10 EUR (tridhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre euro, e dhjetë euro cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritjes për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore për at sa do të krijohen në këtë procedurë përbarimore.

Përbaruesi Privat Irfan Kerçagu me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr. 08/22, të datës 28.01.2022, e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar Urdhrin për lejimin e përbarimit, me arsyetimin se borxhi të cilin debitori e ka ndaj kreditorit është në vlerë prej 30,533.10 EUR, ashtu siç përcaktohet edhe në faturë, ndërsa kreditori, në propozimin për përbarim ka kërkuar përbarimin e shumës prej 30,553.10 EUR, andaj borxhi i kërkuar nga kreditori nuk pasqyron borxhin e vërtetë të cilin debitori duhet ta përmbush. Me kërkesë që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përbarimit. Kreditori, ka parashtruar përgjigje në prapësim duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim, për faktin se debitori, nga vet prapësimi i ushtruar e pohon borxhin dhe detyrimin ndaj kreditorit, ndërsa sa i përket pretendimit se kreditori po kërkon borxh më të lartë sesa fatura, është qartazi e pabazuar. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përbarimit të ngelet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar 1680/22 të datës 30.06.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit DT MINING Sh.p.k., me numër unik identifikues 811287350, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përbarimor P.nr. 08/22, i lejuar me datë 28.01.2022, nga Përbaruesi Privat Irfan Kerçagu, për pjesën e detyrimit në shumën prej EUR 20.00. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit DT MINING Sh.p.k., me numër unik identifikues 811287350, për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR

30,533.10, së bashku me kamatëvonesën prej 8% në vit, dhe në këtë pjesë ka lënë në fuqi Urdhri Përbarimor P.nr. 08/22, i lejuar me datë 28.01.2022, nga Përbaruesi Privat Irfan Kerçagu.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Urdhri Përbarimor P.nr. 08/22, i lejuar me datë 28.01.2022, gjeti se Fatura nr. 2020-SHV01-001-14 të datës 01.09.2020 në bazë të së cilës është lejuar përbarimi, përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Tutje gjykata vlerësoj se përkundër faktit se fatura e lartcekur nuk përmban nënshkrimin e debitorit si në faturë, e njëjta rezulton të jetë e përshtatshme për përbarim nisur nga fakti se debitori, në prapësimin e tij të ushtruar 01.02.2022, e pohon në tërësi borxhin i cili figuron në faturën mbi bazën e të cilës është lejuar përbarimi, duke theksuar se i njëjti ka obligim ndaj kreditorit shumë prej 30,533.10 EUR, ashtu siç pasqyrohet në faturën e lartcekur, andaj nga ky deklaram rezulton se debitori është i njoftuar lidhur me detyrimin që buron nga fatura e lartcekur, dhe të njëjtën e ka pranuar pa kundërshtim. Mbi këtë bazë Gjykata vlerëson se dokumenti mbi bazën e të cilit është mbështetur propozimi për përbarim, dhe është lejuar përbarimi paraqet bazë për lejimin e përbarimit dhe e njëjta ka tipare të përbarueshmërisë.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim gjeti se në propozimin për përbarim, kreditori ka kërkuar përbarimin ndaj debitorit në shumë prej 30,553.10 EUR, e cila vlerë tejkalon vlerën e detyrimit që rrjedh nga fatura nr. 2020-SHV01-001- 14 për shumë prej 20,00 (njëzet euro), andaj Gjykata gjeti se urdhri për lejimin e përbarimit për këtë pjesë të përbarimit duhet shfuqizuar, pasi që lidhur me shumë prej 20,00 EUR, kreditori nuk është i autorizuar që të kërkoj përbarimin ndaj debitorit, andaj u vendos si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, duke u shfuqizuar urdhri për lejimin e përbarimit në vlerë prej 20,00 EUR.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin përbarimor për pjesën e borxhit prej 20.00€, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditori ka kërkuar përbarimin ndaj debitorit në shumë prej 30,553.10 EUR, e cila vlerë tejkalon vlerën e detyrimit që rrjedh nga fatura nr. 2020-SHV01-001- 14 për shumë prej 20,00 (njëzet euro) dhe urdhri për lejimin e përbarimit për këtë pjesë të përbarimit duhet shfuqizuar, pasi që lidhur me shumë prej 20,00 EUR, kreditori nuk është i autorizuar që të kërkoj përbarimin ndaj debitorit, andaj e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 37 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, sa i përket pikës II të dispozitivit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur

refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit ndërsa ka lejuar urdhrin përmbarimor në shumën prej 30,533.10 EUR, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore të debitorit kur ka theksuar se kemi pasur marrëveshje verbale në mes të DT Mining dhe Premium Bau që vlera e kësaj fature të paguhet me kompensim dhe jo me para, po ashtu pretendimet e kreditorit se prapësimi është i pa bazuara dhe se nuk qëndrojnë pohimet e debitorit nuk qëndrojnë fare për shkak se kreditori i ka ofruar vazhdimisht debitorit material të ndryshme si zhavorr, bitum, cement, dhe asfalt për ta mbyllur obligimin që kreditori ka ndaj debitorit, pra kreditori ka dashur për ta dëmtuara financiarisht debitorin pasi që vlerën e kompensimit e ka paraqitur si vlerë që duhet të paguhet me para të gatshme, Për gjykatën të njëjtat mbesin të pabazuara pasi që me shikim në shkresat e lëndës kjo gjykatë vlerëson se debitori në ankesë nuk ka arrit të argumentojë se as nuk ka bashkëngjitur ndonjë prove juridikisht të vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1229/23 me datë 01.03.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**